



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi i njohur, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020, morri

VENDIM

Procedura për lëndën numër 12-2213 nga viti 2020 formuar në bazë të denoncimit për korrupsion nr. 12-2213/1 me datë 15.06.2020 dorëzuar nga parashtruesi

NDËRPRITET

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndë me numrë 12-2213 nga viti 2020, sepse për të njëjtan akuza të lëndës zhvillohet procedura nga organ tjetër – gjyqi kompetent.

Përshkak mosveprimit të komunës me kërkesë së KSHPK dhe mosdorëzimit të të dhënave të nevojshme dhe informacioneve, KSHPK do të ngritë procedurë për kundërvajtje kundër personit përgjegjës në komunën

Lënda me numër 12-2213 nga viti 2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin – në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqe e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numrë 12-2213 nga viti 2020 është formuar në bazë të kërkesës për ngritje të padisë për kallëzim penal nr. 12-2213/1 me datë 15.06.2020, dorëzuar deri në Komisionin shtetëror për parandalim të korrupsionit nga ana e

Inspektorati, si organ i pavarur shtetëror në përputhje me autorizimet ligjore bënë kontrollë inspektimi dhe mbikqyrje në punën e Njesisë për urbanizim dhe ndërtimari në komunat në RMV. Pas njohurime dhe informacioneve të dorëzuara nga një grup qytetarësh nga RMV, me akuza se investitor i pa njohur bëri ndërtim pa leje të objektit në rr. komuna e dhe duke keqpërdorur Ligjin për ndërtim pa leje të objekteve e dëmtoi buxhetin e RMV duke iu ikur pagesës së komunaleve në përputhje me Ligjin për ndërtim në mënyrë që e legalizoi objektin në kundërshtim me Planin detal urbanistik në komunën e përmendur.

Kah kjo lëndë është bashkangjitur edhe lënda e vulosur me numër 12-2285 nga viti 2020 e cila është formuar me kërkesë nga për ngritje të kallëzimit penal nr.12-2285/1 me datë 26.06.2020, me arsyje se bëhet fjalë për lëndë të formuar pas dy denoncimeve të parashtruara nga parashtruesi i njëjtë dhe me të njëjtat akuza në lëndë.

Për shkak të caktimit të gjendjes faktike, deri në Komunën e Prokuroria themelore publike dhe Drejtoria e policisë financiare, KSHPK dërgoi kërkesë për dorëzim të informacioneve dhe të dhënave në lidhje me akuzat e lëndës. Pas kërkesës së KSHPK është dorëzuar lajmërim dhe pas rishikimit në dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

Denoncimi i dorëzuar në realitet paraqet kërkesë që KSHPK të ngritë kallëzim penal kundër komunës përshkak se Komuna nuk ka vepruar për kërkesën e dhe nuk ka siguruar kushte për kryerje të inspektimit mbi objektin e dyshimtë në rrugën Në përputhje me kompetentat ligjore për veprim për aneksat, inspektorati i ndërtimit pranë veproi pas denoncimit të dorëzuar edhe deri në inspektorati i autorizuar i ndërtimit pranë komunës dorëzoi Kërkesë për lajmërim me numër me datë 31.07.2019, me kërkesë në afat prej 5 ditë të veprohet për ankesat e cila në përputhje me procesin e decentralizimit dhe miratimi i Ligjit për vetëqeverisje lokale, Ligji për planifikim hapsinor dhe urbanistik dhe Ligji për ndërtim, miratimi dhe zbatimi i akteve administrative për objekte të kategorisë së dytë ka qenë në kompetencë të komunës në kufijt e të cilës gjendet objekti, në rastin konkret të komunës

Pas kalimit të afatit të dhënë për veprim, komuna nuk u përgjigj në kërkesën, për këtë shkak është dërguar Urgencë me nr me datë 12.09.2019, mirëpo edhe pas urgencës nuk është marrë përgjigje kthyese. Në bazë të këtij veprimi shpreh dyshim se Komuna nuk ka dhënë asnjë lloj dokumenti për miratim të ndërtimit të objektit në lokacionin e theksuar, gjegjësisht se objekti është ndërtim pa leje, dhe në përputhje me kompetencat ligjore, duhet të ndërmerret hap tjetër.

Me datë 24.01.2019 në përputhje me obligimet e veta ligjore, inspektorati shtetëror e informoi komunën me kryerje të një inspektimi të jashtëzakonshëm në Komunë në bazë të nenit 131 paragrafi 4 nga Ligji për ndërtim, vulosur me nr, me çka është kërkuar prezencë e inspektorit të autorizuar i ndërtimtarisë për inspektim në procedurat e udhëhequra dhe kontrollë në vend-ngjarje të objektit në Komunë. Edhe përkaj kësaj kërkesë komuna nuk ka vepruar, edhe pse për atë ka qenë e informuar me kohë nëpërmjet shkrimit. Ky Lajmërim ka qenë pranuar në arkivën e Komunës me datë 24.01.2020 (e parë në vulën e pranuar).

Nga ana e Komunës deri në ditën e parashtrimit të denoncimit deri në KSHPK 15.06.2020 nuk është vepruar pas kërkesës së e as që është përgjigjur për të njëjtën, me çka është penguar që ta kryen kompetencën e vet ligjore dhe ta bëjnë inspektimin e planifikuar të jashtëzakonshëm në Komunën e përmendur. Nga ky shkak drejtohet deri në KSHPK me kërkesë për ngritje të kallëzimit penal dhe kërkon që KSHPK të ndërmerr masa në përputhje me kompetencat e veta.

Në ndërkohëU në denoncimin e tij informon se për rastin konkret janë dorëzuar denoncime edhe deri në Prokurorinë themelore publike dhe Drejtorinë e policisë financiare. Në bashkangjitje të kërkesës janë dorëzuar: kopje nga kallëzimi penal me datë 30.07.2019; kopje nga Kërkesa për lajmërim deri në Komunën me datë 31.07.2019, kopje nga Urgenca deri në Komunën me datë 12.09.2019 dhe kopje nga Lajmërimi për kryerje të inspektimit të jashtëzakonshëm, dorëzuar deri në komunën me datë 24.01.2020.

Me datë 06.11.2020 nga Prokuroria themelore publike Shkup deri në KSHPK dorëzoi lajmërim me informacione se deri në këtë prokurori me datë 15.06.2020 është pranuar kërkesë nga nr. / për ngritje të kallëzimiti penal kundër kryesi të panjohur për veprën penale – ndërtim pa leje nga neni 244-a të Kodit Penal për ndërtim pa leje të objektit në rr. ” ” në Komunën në bazë të kallëzimit penal të dorëzuar deri në inspektorat nga grupë qytetarësh nga Shkupi. Është lajmëruar se pas kërkesës së dorëzuar për ngritje të

procedurës penale, në këtë prokurori publike kompetente është formuar lëndë PO nr...../....., e cila është në fazën e procedurës parahulumtuese.

Komuna nuk ka vepruar për kërkesën e KSHPK dhe në afatin ligjor nuk janë dorëzuar të dhënat e kërkuara dhe informacione në lidhje me rastin e lëndës, me çka KSHPK konstaton se është bërë shkelje nga ana e personit përgjegjës në Komunë sipas nenit 23 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, e cila është e dënuar sipas nenit 100 nga i njëti Ligj. Për shkeljen e konstatuar KSHK do të nise procedurë për kundërvajtje.

Nga gjendja faktike e konstatuar më sipër, KSHPK konstaton se në bazë të akuzave të dorëzuara në denoncim ka vepruar në përputhje me kompetencat e veta dhe para organeve kompetente është dorëzuar kërkesë për ngritje të kallëzimit penal kundër personit – investitorit, pas të cilës Prokuroria themelore publike – Shkup ka formuar lëndë e cila është në procedurë parahulumtuese.

Duke pasë parasysh të theksuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dipozitë të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 14 Dhejtor të viti 2020 me numër 12-2213/6

Dorëzuar deri te: arkiva dhe parashtruesi

Pas përfundimit të KSHPK

Punoi: J. C., këshilltarë

Miratoi: K. H., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР ПЁR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT

Kyetar: Biljana Ivanovska